



AGJENCIA PËR MBËSHTETJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 7, alinea 9 të Ligjit për themelimin e Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15, 39/16, 167/18 dhe 190/19), Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 10/2021 për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2021

I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e mbështetjes financiare për masat në vijim:

| Grupi i masave | Emri i masës | Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme |
|----------------|---|--|
| Masa 121 | Investime për modernizim të ekonomive bujqësore | |
| 121.4 | Furnizim i sistemit të ujitjes pikë pas pike, konstruksione të puseve dhe përfshirjeve tjera të ujit sipërfaqësor | Deri më 1.800.000,00 denarë për investime në sistemin e ujitjes pikë pas pike dhe deri më 364.000,00 denarë për investime në konstruksione të puseve dhe përfshirjeve tjera të ujit sipërfaqësor |

II. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Të drejtë në shfrytëzim të mjeteve kanë subjektet në vijim:

| Subjekte | MASA |
|--|------|
| Ekonomi bujqësore të regjistruara në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural. | 121 |

III. SHUMA E MBËSHTETJES FINANCIARE

Mjetet janë të parapara për investime për furnizim të mjeteve të reja themelore, shpenzime operative në lidhje me mjetet e furnizuara dhe shpenzime të tjera të parapara me Programin për mbështetje financiare në zhvillimin rural për vitin 2021.

Mbështetja financiare paguhet në parimin e bashkëfinancimit të investimeve të përfunduara dhe të paguara nga përdoruesit në shumën prej 50% të vlerës së kostove të lejuara të investimeve, nëse nuk është përcaktuar ndryshe.

Shkalla e bashkëfinancimit për Masën 121 rritet në rastet kur:

- bëhet fjalë për investime të një ekonomie bujqësore mbajtësi i së cilës është një fermer i ri deri në 55%

-për investime në zona me mundësi të kufizuara për prodhimtari bujqësore deri në 60%

-për investime në zona me mundësi të kufizuara për prodhimtari bujqësore kur mbajtësi i investimit është një fermer i ri 65%

- për investime në komunitete rurale të paarrishme 75%

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI QË DORËZOHET

Aplikimet dorëzohen në mënyrë elektronike pas regjistrimit në e-baranje.ipardpa.gov.mk

Një aplikant mund të paraqesë vetëm një kërkesë për një masë ose maksimumi dy kërkesa për mbështetje nën masë të ndryshme, duke marrë parasysh masat e tjera të Programit të Mbështetjes Financiare të Zhvillimit Rural 2021.

Kushtet që duhet të plotësojnë aplikantët e mjeteve përcaktohen me:

Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2021 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 12/21, 31/21, 53/21, 79/21, 92/21, 121/21, 166/21, 175/21, 261/21 dhe 277/21)

Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 88/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17 dhe 83/18)

Rregullorja për kushte më të afërta shtesë për mbështetjen e masave të zhvillimit rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 35/16, 101/17, 162/18, 100/19, 215/19, 24/20, 96/21 dhe 276/21) dhe

Rregullorja për kushte më të afërta shtesë për mbështetjen e masave të zhvillimit rural, kostot e pranueshme dhe shumën e mbështetjes për kostot e pranueshme për përdorues për masë individuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 124/11, 80/13, 72/14, 35/16, 59/16, 178/18, 77/19, 214/19 dhe 276/21)

Kërkesat e mbështetjes financiare duhet të krijojnë kërkesë elektronike për mbështetje financiare me të dhënat për lokacionin e investimit, të dhëna për investimin dhe në mënyrë elektronike të bashkëngjisin dokumentet (ofertë/profaturë për investimin e propozuar dhe plan afarist të përpiluar në pajtim me formularin e paraparë "Plani afarist")

Aplikantët që kanë përmbushur kushtet për shfrytëzimin e mjeteve për masat 121 rangohen me pikë të përcaktuara në Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve sipas masave për zhvillim rural.

- **Kërkesat me numër të njëjtë pikësh do të rangohen sipas datës dhe kohës për parashtrimin e kërkesës elektronike në e-baranje.ipardpa.gov.mk**

- **Aplikantët nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkëfinancim me Agjencinë**

- **Kërkesat që nuk parashtrihen në formë elektronike në e-baranje.ipardpa.gov.mk nuk do të shqyrtohen.**

V. TËRHEQJA E FORMULARËVE DHE UDHËZIMET

Udhëzimet për regjistrimin e aplikantëve në sistemin e paraqitjes elektronike të kërkesës për pagesë mund të shkarkohen në faqen kryesore të e-baranje.ipardpa.gov.mk. Udhëzuesi i përdorimit për masën individuale mund të shkarkohet pasi të filloni të krijoni një kërkesë për masën. Udhëzimi për shfrytëzuesit mund të merret në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk, ose mund të merret drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 08:30 deri në ora 16:30 në adresën:

**Agjencia për mbështetje financiare dhe zhvillim rural
Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C) 1000 Shkup**

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara në mënyrë elektronike për përkrahje financiare duhet të merret, printohet dhe nënshkruhet dhe së bashku me dokumentacionin e shoqëruar të parashtrihet deri te Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural në zarf të mbyllur në të cilin në anën e parme në këndin e epërm të majtë qëndron **Kërkesë për përkrahje financiare dhe Numri arkivues i Kërkesës (1021-12116-XXXX/1)**. Kërkesa mund të parashtrihet përmes postës ose personalisht në sportelin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për arritje jo në kohë ose të pakompletuar në sportel ose për hapje të parakohshme të kërkesës.

Afati përfundimtar për parashtrimin e kërkesave është 27.01.2022.

Kërkesat e parashtruara pas afatit të paraparë nuk do të shqyrtohen.

Informacione më të hollësishme në kontakt telefonin (02) 3097-460 ose kontakt e-mail adresën:

ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk

Kontakt:

**Agjencia për mbështetje financiare dhe zhvillim rural,
Sektori për miratim të projekteve.**

Telefoni 02 3097-460, çdo ditë pune prej ora 08:30 deri në ora 16.00

E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk